

RAPORTI I KARTËS SË ZËRIT TË KOMUNITETIT

Bashkia Rrogozhinë

Përgatitur nga:

Qendra Burimore e Alternativave të Zhvillimit (DARC)



Gusht, 2017

Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje	4
2. Metodologjia	5
2.1 Studim materialesh dhe të dhënash dytësore	5
2.2 Kërkimi cilësor	6
2.3 Kërkimi sasior	6
3. Bashkia Rrogozhinë	7
3.1 Kuadri Demografik	7
3.2 Kuadri Social	7
3.3 Kuadri ekonomik	7
4. Analiza e të dhënave	8
6. Konkluzione dhe Rekomandime	16
7. Pyetësi i kartës së zërit të komunitetit (bashkengjitur)	18

Lista e tabelave

<i>Tabela 1: Informacion i përgjithshëm mbi Rrogozhinën</i>	4
<i>Tabela 2: Treguesit e popullsisë, sipas njësive administrative, Bashkia Rrogozhinë</i>	7
<i>Tabela 3: Treguesit social sipas njësive administrative, Bashkia Rrogozhinë</i>	7
<i>Tabela 4: Treguesit ekonomik sipas njësive administrative, Bashkia Rrogozhinë</i>	8

Lista e Grafikëve

<i>Grafiku 1: Gjinia e të anketuarve</i>	8
<i>Grafiku 2: Grup-mosha e të anketuarve</i>	8
<i>Grafiku 3: Arsimimi i të anketuarve</i>	9
<i>Grafiku 4: Punësimi i të anketuarve</i>	9
<i>Grafiku 5: Niveli i të ardhurave të të anketuarve</i>	10
<i>Grafiku 6: Niveli i shërbimit të furnizimit me ujë të pijëshëm</i>	10
<i>Grafiku 7: Problemet e shërbimit të furnizimit me ujë të pijëshëm</i>	11
<i>Grafiku 8: Përmirësimi i shërbimit të furnizimit me ujë të pijëshëm</i>	11
<i>Grafiku 9: Informimi nga Bashkia për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kostot e tij</i>	12
<i>Grafiku 10: Gadishmëria për të paguar për shërbim të përmirësuar</i>	13
<i>Grafiku 11: Ndjekja e seancave dëgjimore për shërbimin e furnizimit me ujë të pijëshëm</i>	14
<i>Grafiku 12: Akeni lidhur një kontratë shërbimi për furnizimin me ujë?</i>	14
<i>Grafiku 13: Rregullsia e faturave të shërbimit</i>	15

1. Hyrje

Bashkia Rrogozhinë kufizohet në veri me bashkinë Kavajë, në veri-lindje me bashkinë Tiranë, në jug me bashkinë Lushnje, në lindje me bashkinë Peqin dhe në perëndim me detin Adriatik. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Rrogozhinës.¹Popullsia: Sipas INSTAT, Census të vitit 2011, bashkia e re numëron 22,148 banorë, ndërsa sipas sipas Regjistrit të Gjendjes Civile ajo numëron një popullsi prej 40,684 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 223.5 km². Sipas regjistrit civil, densiteti i popullsisë është 182 banorë/km², ndërsa sipas Censurit, densiteti është 99 banorë/km².²

Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Rrogozhinë, Kryevidh, Sinaballaj, Lekaj dhe Gosë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e qarkut të Tiranës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 36 fshatra. Bashkia e re e Rrogozhinës shtrihet në një terren pjesërisht kodrinor dhe pjesërisht fushor deri në bregun e detit. Bashkia e re ka për qendër qytetin e Rrogozhinës, i cili u krijua në kohën e komunizmit përreth agro-industrisë, si fabrika e vajit dhe sapunit apo ajo e zhveshjes së pambukut, si dhe një linjë për përpunimin dhe konservimin e ushqimeve. Kjo industri tashmë është mbyllur prej kohësh. Njësitë administrative rurale përbërëse të bashkisë së re kanë lidhje të kufizuara me qendrën e saj. Qyteti i Rrogozhinës zë rreth një të tretën e të gjithë popullsisë banuese të bashkisë së re.

Dy komunat bregdetare, Gosa dhe Kryevidhi, kanë mundësi të zhvillojnë turizmin por aktualisht infrastruktura e disponueshme rrugore drejt bregdetit është shumë e kufizuar, ndërsa infrastruktura e nevojshme për furnizim me ujë apo kanalizime është inekzistente.

Bashkia e re do të përfshijë edhe zona të rëndësishme bujqësore, të cilat kanë nevojë për mirëmbajtje të infrastrukturës rurale, sidomos lidhur me sistemet vaditëse dhe kanalet kulluese.

Tabela 1: Informacion i përgjithshëm mbi Rrogozhinën

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas regjistrit civil	Sipërfaqja Km ²
Tiranë	Qyteti Rrogozhinë	Rrogozhinë	Qyteti Rrogozhinë, fshati; Rrogozhinë	22,148	40,684	223.5
		Kryevidh	Fshatrat: Kryevidh, Ballaj, Rreth-Greth, Patkë-Milot, Zhabjak, Spanesh, Spille, Domën, Stërbeg, Shardushk, Kazie			

¹ INSTAT, Census 2011

² INSTAT, Census 2011

		Sinaballaj	Fshatrat; Sinaballaj, Methasanaj, Hazdushk, Hamenraj, KoçajSheshaj, Thartor, Rrostej, Fliballije, Demarkaj		
		Lekaj	Fshatrat; Lekaj, Harizaj, German, Zambish, Mushnik, Mlik, Okshtun, Luz i madh, Shkozet , Kryeluzaj		
		Gosë	Fshatrat; Gosë e Madhe, Gosë e Vogel, Kalush, Kërçukaj, Vilë- Ballaj		

Informacioni i përfshirë në këtë raport prezanton ecurinë e procesit të monitorimit dhe vlerësimit të Kartës së Zërit për shërbimin e furnizimit me ujë në Bashkinë Rrogozhinë dhe Njësitë Administrative Sinaballaj dhe Gosë në periudhën e Maj- Korrik të vitit 2017.

Ky vlerësim u realizua përmes përfshirjes së drejtpërdrejtë të komunitetit, dhe u synua jo vetëm që komuniteti të vlerësojë me pikë performancën e shërbimit të furnizimit me ujë që i ofrohet, por edhe të diskutojë e sugjerojë ndryshime dhe reforma për të përmirësuar këtë shërbim.. Gjithashtu projekti përdori grupet e krijuara të monitorimit për të mbledhur opinionet e komunitetit nëpërmjet Kartës së Zërit të komunitetit.

2. Metodologjia

Kryesisht ky raport përdor të dhënat e mbledhura nga komuniteti nëpërmjet KZK. Gjithashtu, raporti bazohet edhe në përdorimin e disa metodave kërkimore, konkretisht: kërkimin dytësor, kërkimin sasior dhe kërkimin cilësor.

2.1 Studim materialesh dhe të dhënash dytësore

Kjo metodë përfshin mbledhjen e të dhënave që tashmë ekzistojnë, sidomos nga të dhënat dhe raportet e ekzistuese të Bashkisë Rrogozhinë.

Tipologjia e të dhënave dhe dokumentacionit të marrë nga bashkia është si më poshtë:

1. Të dhëna demografike - të cilat përfshijnë të dhëna sa i takon numrit të fshatrave, familjeve, popullsisë për çdo njësi administrative, dhe numrin gjithsej të të punësuarve në Bashki, numrin e

të punësuarve në pozicione drejtuese dhe numrin gjithsej të anëtarëve të këshillit bashkiak të agreguara sipas gjinisë

2. Të dhëna sociale – të cilat përfshijnë numrin e personave dhe familjeve që marrin asistencë sociale si dhe numrin e objekteve të tilla si shkolla, qendra shëndetësore etj.

3. Të dhëna ekonomike - duke përfshirë të dhë nat në lidhje me buxhetin e fundit të çdo bashkie me të ardhurat dhe shpenzimet përkatëse, si dhe informacion mbi numrin e bizneseve dhe fermave në nivel njësie administrative.

2.2 Kërkimi cilësor

Kërkimi cilësor është realizuar përmes teknikave të ndryshme, duke përfshirë intervista gjysmë të strukturuar me qytetarët dhe profesionistë kyç të ofrimit të shërbimit të furnizimit me ujë.

Kështu, në procesin e vlerësimit të Kartës së Zërit për shërbimin e furnizimit me ujë u përfshinë qytetarët e Njësi Administrative: Rrogozhinë, Sinaballaj dhe Gosë. Paralelisht me ta u intervistuan edhe punonjësit e ofruesit të shërbimit të furnizimit me ujë.

Çështjet mbi të cilat u realizua monitorimi në bazë të KZK ishin të ngjashme me ato që u diskutuan nëpër fokus grupet me komunitetin, në mënyrë që të merrej informacion për çështje të njëjta si nga komuniteti, ashtu edhe nga ofruesit e këtij shërbimi.

Elementë të ndryshëm të furnizimit me ujë si Cilësia dhe efikasiteti e shërbimit të furnizimit me ujë u evidentua në bazë të rezultateve të dalës dhe të analizuar nga ky monitorim i komunitetit dhe ndërmarrjes/bashkisë që ofrojnë këtë shërbim..

Përveç grupeve të fokusuar, vlerësimi dhe monitorimi u realizua edhe përmes ngritjes së 3 grupe monitorimi vullnetare (të rinj dhe të reja) që monitoruan shërbimin e furnizimit me ujë të pijëshëm.

2.3 Kërkimi sasior

Komponenti i kërkimit sasior për qëllimin e këtij raporti përfshin pyetësin e Kartës së Raportimit të Qytetarëve, e njohur edhe si Karta e Zërit.

Anketa mblodhi zërin e qytetarëve në lidhje me shërbimin e furnizimit me ujë të pijëshëm.

Në bashkinë Rrogozhinë janë shpërndarë 500 pyetësore të Kartës së Zërit, 38% në Njësinë Administrative Rrogozhinë, 31% në Njësinë Administrative Sinaballaj dhe 31% në Njësinë Administrative Gosë.

3. Bashkia Rrogozhinë

3.1 Kuadri Demografik

Pas Reformës Administrative Territoriale, bashkia Rrogozhinë ka 5 njësi administrative. Bashkia Rrogozhinë ka një popullsi prej 22,148 banorë (sipas INSTAT, Census 2011) dhe 40,684 banorë (sipas Regjistrit të Gjendjes Civile) familje. Bashkia Rrogozhinë ka 17,832 familje. Kjo bashki në përbërjen e saj ka 1 qytet (i cili ka 2 lagje) dhe 36 fshatra³.

Tabela 2: Treguesit e popullsisë, sipas njësive administrative, Bashkia Rrogozhinë

Treguesit	Rrogozhinë	Sinaballaj	Kryevidh	Lekaj	Gosë
Popullsi ⁴	13,651		9,384	9,506	8,724
Popullsi ⁵	7,049	1,191	4,662	5,126	4,120
Familje	4,056		9,384	2,246	2,146
Fshatra	-	8	12	10	6

3.2 Kuadri Social

Bashkia Rrogozhinë ka 17 kopshte, 18 shkolla 9-vjeçare, si dhe 2 shkolla të mesme. Kjo bashki ka 4 qendra shëndetësore dhe në total qyteti së bashku me njësitë kanë 29 ambulanca⁶.

Tabela 3: Treguesit social sipas njësive administrative, Bashkia Rrogozhinë

Treguesit	Rrogozhinë	Sinaballaj	Kryevidh	Lekaj	Gosë
Kopshte	1	1	7	4	4
Shkolla 9-vjeçare	2	1	7	4	4
Shkolla të mesme	1	-	-	-	1
Qendra Shëndetësore	1	-	1	1	1

Pjesa më e madhe e këtyre shkollave dhe kopshteve mbulohet nga furnizimi me ujë të pijshëm përmes puseve.

3.3 Kuadri ekonomik

Shkalla e papunësisë në bashkinë Rrogozhinë arrin në 24,7% sipas të dhënave të INSTAT, Census 2011⁷. Aktualisht në këtë bashki veprojnë 598 biznese dhe 2376 ferma, të ndara sipas njësive administrative në tabelën e mëposhtme:

³Bashkia Rrogozhinë, 2016

⁴Regjistri i Gjendjes Civile

⁵INSTAT, Census 2011

⁶Sipas të dhënave nga bashkia Rrogozhinë

Tabela 4: Treguesitekonomiksipasnjësiveadministrative, BashkiaRrogozhinë

Treguesit	Rrogozhinë	Sinaballaj	Kryevidh	Lekaj	Gosë
Biznese	227	11	141	97	122
Ferma	-	525	1846	-	5


Bashkia Rrogozhinë ka të përcaktuar një fond prej 17,728,184 lekë për ndihmën ekonomike nga ku përfitojnë 569 familje në total. Ndërsa për fondin e paaftësisë bashkia ka përcaktuar fondin prej 64,937,770lekë ku përfituese janë 339 persona dhe 112 kujdestarë

4. Analiza e të dhënave

Të dhëna demografike

Nga 500 të anketuar në tre njësitë administrative të Bashkisë Rrogozhinë, 51% e tyre ishin meshkuj dhe 49% femra.


Grafiku1: Gjinia e të anketuarve



Siç mund të vihet re në grafikun e mëposhtëm, pjesa më e madhe e të anketuarve janë të grup-moshës 35-49 vjeç, përkatësisht 48% e tyre. Rreth 27% janë të grup-moshës 25-34 vjeç; ndërkohë, në një masë më të vogël, të anketuarit janë të grup-moshave 18-24 si dhe 50-64 vjeç, respektivisht 12% dhe 11% e tyre


Grafiku2: Grup-mosha e të anketuarve.

⁷ INSTAT, Census 2011




Të anketuar kanë kryesisht arsim të mesëm, rreth 78% e tyre; vetëm 1% e tyre kanë arsim universitar; pjesa tjetër kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 8-vjeçar. Ndër ta nuk ka analfabet, që nuk kanë mbaruar asnjë shkollë apo vetëm me shkollë fillore.

Grafiku3: Arsimimi i të anketuarve.




Përbërja e të anketuarve sipas punësimit është 2% pensionist, 84% të papunë (përfshirë shtëpiaket), 12% të punësuar (përfshirë të vetë punësuarit) dhe 2% studentë. Për 81% të të intervistuarve të ardhurat mesatare mujore familjare janë deri në 40 mijë lekë dhe për 14% në intervalin 40 – 100 mijë lekë. Asnjë prej të intervistuarve nuk deklaroi të ardhura mujore familjare më të mëdha se 100 mijë lekë.

Grafiku4: Punësimi i të anketuarve.




Grafiku5: Niveli itë ardhurave të tëanketuarve.



Cilësia e ofrimit të shërbimit të furnizimit me ujë të pijëshëm.


Siç mund të vihet re, pjesa më e madhe e të anketuarve janë të mendimit se shërbimi i furnizimit me ujë në qytet është përgjithësisht i keq; kështu, rreth 91% e kanë vlerësuar si të keq (këtu përfshihet edhe aspak i mirë dhe shumë i keq), ndërkohë vetëm 8% e vlerësojnë këtë shërbim si të mirë.

Grafiku 6: Niveli i shërbimit të furnizimit me ujë të pijëshëm.




Pjesa më e madhe e të anketuarve, rreth 82% e tyre, shprehen se problem më i ndjeshëm për ta është se shërbimi nuk ofrohet rregullisht, ndërkohë rreth 14% të tjerë janë shprehur se nuk kanë rrjet apo rrjeti ndodhet larg zonës së tyre.

Grafiku 7: Problemet e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm.




Për pjesën më të madhe të të anketuarve, 67% e tyre, ndërgjegjësimi i qytetarëve për pjesëmarrjen në monitorimin e shërbimit të furnizimit është një mënyrë përmes së cilës mund të përmirësohet ky shërbim. Rreth 31% e të anketuarve janë të mendimit se rol për përmirësimin e këtij shërbimi do të luanin politikat e bashkisë dhe vetëm 2% e tyre janë shprehur vendosja e gjobave për shkelësit e ligjit dhe përdoruesit e parregullt të ujit.

Grafiku 8: Përmirësimi i shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm.




Vetëm 7% e të anketuarve janë shprehur se bashkia i informon mbi shërbimin e furnizimit me ujë dhe kostot e tij, ndërkohë pjesa më e madhe e tyre janë shprehur se bashkia nuk i informon, siç vihet re dhe në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku9: Informimi nga Bashkia për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kostot e tij.




Siç mund të vihet re edhe në grafikun e mëposhtëm, informimi vazhdon të mbetet një problem më vete; kështu, të anketuarit janë shprehur se bashkia/operatori i informojn pak mbi vendosjen e tarifave dhe se mendimi i tyre nuk merret në konsideratë.

Grafiku 10: Informimi mbi tarifën e shërbimit të furnizimit me ujë.




Rreth 83% e të anketuarve janë shprehur aspak dhe pak dakord se shërbimi i marrë është në këmbim të pagesës së bërë. Ndërkohë, vetëm 16% e tyre janë shprehur dakord dhe shumë dakordë.

Grafiku 11: Marrja e shërbimit kundrejt pagesës.




Pavarësisht se shprehen se nuk marrin shërbimin për të cilin paguajnë, vihet re se përsëri banorët e anketuar janë të gatshëm të paguajnë për të përmirësuar shërbimin e furnizimit me ujë të pijëshëm. Kështu, rreth 19% e tyre janë shumë dakord që të paguajnë, 45% e tyre janë shprehur dakord; ndërkohë jo dakord dhe aspak dakord janë shprehur përkatësisht 18% dhe 17% e të anketuarve.

Grafiku 10: Gadishmëria për të paguar për shërbim të përmirësuar.



Gjatë 12 mujave të fundit vetëm 39% e të anketuarve shprehen se kanë marrë pjesë në një seancë dëgjimore mbi shërbimin e furnizimit me ujë; ndërkohë, rreth 61% e tyre shprehen se nuk kanë marrë kurrë pjesë në njëseance të tillë dëgjimore.


Grafiku 11: Ndjekja e seancave dëgjimore për shërbimin e furnizimit me ujë të pijëshëm.



Rreth 70% e të anketuarve janë shprehur se nuk kanë lidhur një kontratë me operatorin e ujësjellësit dhe vetëm 30% e tyre janë shprehur se e kanë lidhur një kontratë me operatorin e këtij shërbimi.

Grafiku 12: Akeni lidhur një kontratë shërbimi për furnizimin me ujë?


A keni lidhur kontratë shërbimi me kompaninë tuaj të ujësjellësit?



Nga 30% e të anketuarve të cilët shprehen se kanë lidhur një kontratë shërbimi me operatorin e ofrimit të shërbimit të furnizimit me ujë, rreth 87% e të anketuarve janë sghrehur se marrin rregullisht faturat për këtë shërbim.

Grafiku13: Rregullsia e faturave të shërbimit.

A merrni fatura të rregullta për shërbimet e ujit dhe kanalizimit?



1. Konkluzione dhe Rekomandime

Përveç sistemit të Kartës së Zërit pjesëmarrësit në vlerësim patën mundësinë të jepnin edhe komente dhe sugjerime/rekomandime.

Furnizimi me ujë të pijshëm rezulton shumë problematik për të gjitha Njësitë Administrative të përfshira në vlerësim nëpërmjet Kartës së Zërit. Linjat e shpërndarjes janë të amortizuara. Mos furnizimi me ujë gjatë gjithë ditës rrit shpenzimet e konsumatorëve pasi janë të detyruar të përdorin pompa e depozita për të pasur ujë në shtëpitë e tyre.

Në zonat e fshatrave raportohen shpime të paligjshme për furnizim me ujë, si dhe përdorimi i ujit të pijshëm për vaditje apo në lavazhe. Në të tre Njësitë Administrative, Rrogozhinë, Sinaballaj dhe Gosë, komuniteti i përfshirë në vlerësim është shprehur i pakënaqur për bllokimin e vazhdueshëm të kanaleve kulluese, ku ndërhyrjet për pastrim nuk janë të vazhdueshme por vetëm në periudhën e shirave.

Qyteti furnizohet me ujë të pijshëm, por zonat periferike vuajnë. Furnizimi me ujë të pijshëm është me orar.

Banorët e Njësite Administrative u shprehën se ata përballen me problemet e furnizimit me ujë në një pjesë të mirë të territorit ku furnizim me ujë nuk zgjat më shumë se 1-1.5 orë në ditë. Duket se rrjeti i shpërndarjes edhe pse ekzistues, është tejet i amortizuar dhe ndërhyrjet e bëra në të kanë krijuar mjaft problem në furnizimin me ujë. Gjithashtu banorët kanë ankesa për cilësinë e ujit, ku e përshkruajnë atë si gëlqerorë në disa zona.

Informimi:

Në pyetjet e shtruara në pyetëtorin e Kartës së Zërit rezulton:

E përbashkëta e zonës urbane me atë rurale në këndvështrimin e informimit për shërbimin e furnizimit me ujë në bazë të të dhënave të përmbledhura nga Karta e Zërit rezulton se në të dy rastet, komuniteti ka mungesë të theksuar të aksesit në informacion.

Në zonën urbane përdorej më shumë internet ndërsa në zonën rurale burimi kryesor i informacionit janë letra të ngjitura në rrugët kryesore të fshatrave apo takimet informale duke shfrytëzuar njohjet personale me nënpunësit e ndërmarrjes për shërbimin e furnizimit me ujë apo nëpunësit e Njësite Administrative. Edhe Brenda zonës urbane ka diferenca mes qendrës dhe periferisë.

Të gjitha fokus grupet treguan që pjesëmarrësit nuk ishin në dijeni që Bashkia organizonte takime me komunitetin, si një formë që nxiste përfshirjen e mendimit të tyre në vendimmarrje. Vetëm në zonën urbane një pjesë e pjesëmarrësve u shprehën se ishin njoftuar dhe kishin marrë pjesë në takime të tilla, të gjithë pjesëmarrësit në zonat rurale pohuan se ata nuk ishin njoftuar asnjëherë për ndonjë takim që mund të ketë organizuar bashkia e nuk iu është dhënë mundësia të ngrenë problemet e komunitetit të tyre, sidomos atë të furnizimit me ujë, në ndonjë mbledhje të tillë. E vetmja mënyrë që banorët e zonave rurale adresojnë problemet e tyre është përmes

ankesave të depozituara pranë ndërmarrjes së ujësjellësit dhe njësive administrative në mënyrë personale apo në grupe të vogla.

Disa nga gjetjet në Njësitet Administrative të nxjerra nga Karta e Zërit.

- Banorët shprehen se situata në të cilën ata ndodhen është e keqe.
- Banorët shprehen se duhet të përmirësohet furnizimi me ujë dhe cilësia e tij .
- Banorët shprehen se mungon një impiant i furnizimit me ujë për të gjitha zonat e Njësive Administrative përkatëse (Rrogozhinë, Sinaballaj, Gosë).
- Banorët shprehen se kanë kufizime në shërbimin e furnizimit me ujë.
- Banorët shprehen se mungon prezenca e një përfaqësuesi të tyre në takimet me bashkinë.
- Furnizimi me ujë të pijshëm u raportua si problem në të gjitha takimet e zhvilluara me komunitetin dhe në rezultatet e nxjerra nga pyetësorët e Kartës së Zërit duke qenë se është një çështje tejet e ndjeshme për banorët.

Disa nga rekomandimet në Njësitet Administrative të nxjerra nga Karta e Zërit.

- Rekomandohen investime në tubacione.
- Rekomandohet përmirësimi i cilësisë së ujit dhe furnizimit me ujë .
- Rekomandohet të vendoset në funksion një impiant i ri furnizues për të gjithë zonat administrative dhe jo vetëm zonat që ndodhen pranë impiantit.
- Rekomandohet heqja e faturimit afrofe dhe të vendosen matës uji.
- Rekomandohet të vendoset në funksion impianti i trajtimit të ujerave të zeza.
- Kërkohet me ngut ndërhyrja e Bashkisë në zgjidhjen e problemit të kanalizimeve dhe në planifikimin e ndërtimit të rrjetit të ujerave të zeza sidomos në fshatra.